



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE  
DREJTORIA E ANALIZËS LIGJORE DHE HARTIMIT TË AKTEVE**

Nr. 1194/3 prot.

Tiranë, më 07.07.2022

**U R D H Ë R**

Nr. 57, datë 07.07.2022

**“PËR**

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 119, DATË 12.07.2021 “PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË ORGANIZIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË,  
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 204, pika 1, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

**U R D H Ë R O J:**

1. Në urdhrin nr. 119, datë 12.07.2021 “Për miratimin e rregullore së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të ndryshuar”, bëhen këto ndryshime:

a) Neni 86 ndryshon sipas këtij formulimi:

**“Neni 86**

**Rregullat e Etikës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë**

1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, inspektorët përveç sa parashikohet në këtë Rregullore, respektojnë për analogji legjislacionin në fuqi dhe rregullat mbi etikën dhe sjelljen e magjistratit.
2. Në ushtrimin e funksioneve të tyre personeli administrativ i Zyrës së ILD, duhet të njohë dhe të respektojë, parashikimet e ligjit dhe akteve nënligjore për etikën në administratën publike dhe rregullat e sjelljes dhe standardeve të etikës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”.

b) Neni 94 ndryshon sipas këtij formulimi:

**“Neni 94**  
**Veprimtaritë e Jashtme**

Veprimtaritë e jashtme të inspektorëve magistratë rregullohen sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për inspektorët jomagjistratë, anëtarët e Kabinetit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe personelin administrativ, angazhimi në veprimtaritë e jashtme, rregullohet sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në rregullat e sjelljes dhe standardet e etikës të miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.”

c) Neni 95 ndryshon sipas këtij formulimi:

**“Neni 95**  
**Dhuratat dhe Favoret**

1. Ndalimi ose pranimi i dhuratave dhe favoreve për inspektorët jomagjistratë, anëtarët e Kabinetit, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë rregullohen sipas rregullave të sjelljes dhe standardeve të etikës të miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
2. Ndalimi ose pranimi i dhuratave dhe favoreve për inspektorët magistratë rregullohen sipas rregullave të sjelljes dhe standardeve të etikës të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë sipas rastit, si dhe sipas rregullave të sjelljes dhe standardeve të etikës të përcaktuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.
3. Rregulla të detajuara për dhuratat, favoret, vlerën e dhuratave që mund të pranohen, mënyra e administrimit të dhuratave që nuk mund të kthehen dhe procedurat e dhuratave që pranohen, gjenden të përcaktuara në rregullat e sjelljes dhe standardeve të etikës të miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.”.

d) Në nenin 102, pika 3, ndryshon sipas këtij formulimi:

“3. Çdo nëpunës/punonjës i ILD-së pajiset me çelësa, kartë elektronike personale dhe mjet identifikues, të cilat i dorëzon kur përfundon marrëdhënien e punës me ILD. Në rastet kur nëpunësi humbet çelësin, kartën elektronike personale apo mjetin identifikues, njofton pa vonesë njësinë përgjegjëse për burimet njerëzore.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Analizës Ligjore dhe Hartimit të Akteve për të reflektuar ndryshimet e miratuara me këtë urdhër në një tekst të vetëm integral që pasqyron variantin në fuqi të urdhrit nr. 119, datë 12.07.2021 dhe përcjelljen e variantit integral pas miratimit të këtij urdhri, Drejtorisë e Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri dhe variantin integral të rregullores së organizimit dhe funksionimit në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

### **INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

